



**URDHËR**

Nr. 119, Datë 13/11/2015

**Mbi pagesën e tarifës së shkollimit për studentët e ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master" për vitin akademik 2015-2016, në Universitetin e Arteve.**

Mbështetur në nenet 26,34 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 6, 135 të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Vendimin nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifën e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", të ndryshuar, nenit 39, të Statutit të Universitetit të Arteve,

**URDHËROJ:**

1. Studentët e ciklit të dytë me kohë të plotë, **viti i parë**, "Master Profesional", në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve, **pagesën e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2015-2016**, do ta paguajnë si vijon:
  - a) **Kësti i parë**, të paguhet nga studentët deri në masën 30 % të tarifës totale dhe paguhet deri në datën **25 /11/ 2015**.
  - b) **Kësti i dytë**, të paguhet nga studentët deri në masën 40 % të tarifës totale dhe të paguhet deri në datën **30 /01/ 2016**;
  - c) **Kësti i tretë**, të paguhet nga studentët deri në masën 30 % të tarifës totale dhe të paguhet deri në datën **31/04/ 2016**;
  
2. Studentët e ciklit të dytë me kohë të plotë, **viti i parë**, "Master i Shkencave" / "Master i Arteve të Bukura", në Fakultetet e Universitetit të Arteve, **pagesën e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2015-2016**, do ta paguajnë si vijon:
  - a) **Kësti i parë**, të paguhet nga studentët deri në masën 20 % të tarifës totale dhe paguhet deri në datën **25 /11/ 2015**.
  - b) **Kësti i dytë**, të paguhet nga studentët deri në masën 20 % të tarifës totale dhe të paguhet deri në datën **30 /01/ 2016**;
  - c) **Kësti i tretë**, të paguhet nga studentët deri në masën 10 % të tarifës totale dhe të paguhet deri në datën **31/04/ 2016**;



3. Studentët e ciklit të dytë me kohë të plotë, **viti i dytë**, "Master i Shkencave" / "Master i Arteve të Bukura", në Fakultetet e Universitetit të Arteve, **pagesën e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2015-2016**, do ta paguajnë si vijon:
  - a) **Kësti i parë**, të paguhet nga studentët deri **në masën 20 % të tarifës totale** dhe paguhet deri në datën **25 /11/ 2015**.
  - b) **Kësti i dytë**, të paguhet nga studentët deri **në masën 20 % të tarifës totale** dhe të paguhet deri në datën **30 /01/ 2016**;
  - c) **Kësti i tretë**, të paguhet nga studentët deri **në masën 10 % të tarifës totale** dhe të paguhet deri në datën **31/04/ 2016**;
4. Bazuar në VKM nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimiit dhe tarifatat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016", të ndryshuar, pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, *(në kohëzgjatjen normale të tij)*, konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik dyfishin e tarifës për kredit të parashikuar;
5. Studentët që vijnë nga shtresat sociale, sipas përcaktimeve të shtojcës 1/3, të VKM nr. 638, date 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimiit dhe tarifatat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", të ndryshuar, paguajnë 50 % të tarifës vjetore të shkollimit;
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Dekanët dhe Sekretarët e Fakulteteve, Drejtoria Ekonomike, Sektori Mësimore, si dhe Sektori i Statistikës pranë Rektoratit.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

Prof. Petrit MALAJ  
  
REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE